

Çfarë mundësisht keni Ju, për t'i realizuar të drejtat e Juaja?

Nëse rroga e Juaj apo kushtet e punës nuk u përgjigjen

- standardeve minimale ligjore
- rrogës minimale të caktuar me ligj (shiko tabelën)
- predispozitive tarifore,

Ju keni dy mundësi: Mund të ankoheni vetë te punëdhënësi Juaj dhe t'i kërkoni të drejtat e Juaja - ndoshta edhe me një avokat. Ose Ju mund t'i drejtoheni një zyre këshillimi (numrat e telefonit dhe adresat i keni në faqen tjetër). Nëse nuk gjeni gjuhë të përbashkët me punëdhënësin Tuaj, atëherë është gjyqi ai, i cili vendos.

Pa iniciativën Tuaj mund ti humbeni të drejtat e Juaja.

Çfarë mund të bëni Ju vetë, që t'i shfrytëzoni të drejtat Tuaja?

- Shkruani orët që keni punuar, vendin ku punoni, emrin dhe adresën e punëdhënësit.
- Shkruani se çfarë marrëveshje gojore keni arritur me punëdhënësin Tuaj.
- Ruani të gjitha dëshmitë, që kanë të bëjnë me punën Tuaj (kartelën për regjistrimin e orëve, udhëzimet e punës, sms-të/ emaillet e marra nga punëdhënësi).
- Mbani mend emrat e kolegëve Tuaj, që në rast nevojë të lidhni kontakt me ta.
- Kundër një largimi nga puna mund të ngihet padi brenda tri javëve.
- Nëse Juve nuk u paguhet rroga apo merrni pak rrogë, duhet që në një afat sa më të shkurtër kohor të ankoheni te punëdhënësi Juaj.

A ...

- ju mashtron punëdhënësi lidhur me punën apo kushtet e punës?
- ju vë në presion apo ju detyron të bëni orë shtesë? A duhet të bëni punë të rrezikshme kundër vullnetit Tuaj?
- ju pengon të bini në kontakt me njerëzit e tjerë? A nuk mund të lëvizni të lirë? A është dashur ta dorëzoni pasaportën Tuaj? A keni marrë kërcënime?

Veprimet e këtilla i cenojnë në mënyrën më të shëmtuar të drejtat Tuaja. Eksploatimi/shfrytëzimi në punë me anë të mashtrimit, rrjepja nga paga mujore, puna e detyrueshme dhe tregtia me njerëz dënohen me ligj. Në raste të këtilla Ju keni mbrojtje të plotë ligjore dhe u takojnë të drejta të posaçme, që jua garanton ligji. Informata shtesë për vendet e këshillimit mund të gjeni në faqen zyrtare të internetit:

www.gegen-menschenhandel.de

Këtu Ju mund të merrni këshilla dhe të fitoni mbështetje

Beratungsstelle für Migrantinnen und Migranten von Arbeit und Leben e.V. (Zyra e këshillimit për migrantët e punës dhe jetës e.V.)

Beratungsbüro für entsandte Beschäftigte in Berlin
(Zyra e këshillimit për të punësuar të dërguar)
Keithstr. 1-3
10787 Berlin
Tel.: 030 - 21 240 - 325 respektivisht -145
<http://www.berlin-brandenburg.dgb.de/migrantInnen>
www.postedwork.dgb.de

Anlaufstelle für europäische Wanderarbeiterinnen und Wanderarbeiter sowie Roma (Zyra pritëse për punëtorët endacakë evropianë si dhe për romët)

c/o südost Europa Kultur e.V.
Großbeerenstr.88
10963 Berlin
Tel.: 030 / 253 77 99 – 21 und 0176 / 70447036
info@suedost-ev.de, www.suedost-ev.de

Beratungsstelle beim Berliner Integrationsbeauftragten (Zyra e këshillimit tek i ngarkuari për integrimin në Berlin)

Potsdamer Straße 65
10785 Berlin (Mitte, OT Tiergarten)
Tel.: 030 / 9017 23 78
(vetëm këshillim për të drejtat e lejeqëndrimit dhe këshillim social)
www.integrationsbeauftragter-berlin.de

Hollësitë në lidhje me pagat e punës, të caktuara me ligj, i gjeni në faqen zyrtare të internetit të Administratës së Senatit për intergrim, punës dhe çështje sociale.

Regjistri i përbashkët tarifor Berlin dhe Brandenburg

<http://www.berlin.de/sen/arbeits/tarifregister/index.html>

Botues

Administrata e Senatit për intergrim, punë dhe çështje sociale. Zyra e shtypit (V.i.S.d.P.), shtator 2011, botimi i gjashtë i aktualizuar

Nëse për arsye të lexueshmërisë emërtimet, që u referohen personave natyrorë, janë të dhënë vetëm në formën mashkullore, këto u referohen grave dhe burrave në të njëjtën formë.

Kjo fletushkë është pjesë e punës publike të Landit të Berlinit. Ajo nuk është e destinuar për shitje dhe nuk guxon të shfrytëzohet për reklamim të partive politike.

BBGM-ja përkrahet nga:



Aleanca informon ...



Informacione për të drejtat e punëmarrësve

... pavarësisht nga rrethanat e punës dhe statusi i lejeqëndrimit

Për punë të mirë

... kundër shfrytëzimit në punë

... kundër shkurtimeve të rrogës dhe keqtrajtimit social

Liri e plotë e zgjedhjes së banimit
Për punëmarrësit e EU-së
nga 1 maji 2011
(për punëtorët sezonalë nga 1 janari
2011, për bulgarët dhe rumunët
nga 1 janari 2014)

I dini të drejtat Tuaja si punëmarrës?

- E merrni rrogën, të cilën jua kanë premtuar?
- A e dini, nëse Ju e merrni pagën minimale me ligj (shiko tabelën e pagave)?
- Bëni orë shtesë, të cilat nuk ju paguhen?
- A ju paguhet pushimi?
- A e dini se sa ditë pushim ju takojnë?
- A merrni rrogë kur jeni të sëmurë?
- A e rrezikoni shëndetin Tuaj në punë?
- A keni pasur një aksident në punë?
A keni marrë një trajtim mjekësor?
- A e dini se të rinjtë dhe gratë shtatzëna gëzojnë një mbrojtje të posaçme?
- A dëgjohen kërkesat Tuaja në sipërmarrje? A ju informon sipërmarrja Juaj / punëdhënësi Juaj për të drejtat dhe obligimet si punëmarrës?
- A e dini si të mbroheni ndaj largimit nga puna?
- A e di se edhe **pa dokumente** të rregulluara Ju keni të drejta?

.....

Gjatë një punësimi më tepër se një muaj, çdo punëdhënës është i obliguar t'i hedhë në letër pjesët përbërëse të kontratës së punës, ta nënshkruajë atë dhe një kopje t'ia dorëzojë punëmarrësit. **Këtu bëjnë pjesë:** Emri, fillimi dhe kohëzgjatja e punësimit, përshkrimi i veprimtarisë, koha e punës, shuma e pagesës, pushimi, afatet e anulimit të kontratës së punës, udhëzimet për dispozitat ligjore tarifore dhe sipërmarrëse.

E njëjta vlen për ndryshimet thelbësore të kontratës së punës (§ 2 NachwG).

Në Gjermani të gjithë punëmarrësit janë të mbrojtur me ligj.

Kontrata Juaj e punës, të paktën, duhet t'i përmbushë standardet minimale ligjore të pranëvendosura.

Standardet minimale ligjore në Gjermani

Rroga

Rroga, në disa branzhe, nuk guxon të jetë nën tarifën minimale ligjore të pagesës.

Koha e punës / orët shtesë

Ju keni të drejtën e pauzës dhe ditëve të pushimit. Ju nuk guxon të punoni më shumë se 48 orë në javë (prej të hënës deri të shtunën). Përrjashtimet janë të mundshme. Orët shtesë duhet të paguhen apo të kompensohen me ditë të lira.

Pushimi

Për një javë 5-ditëshe punëmarrësi merr 20 ditë pushim në vit, për një javë 6-ditëshe 24 ditë dhe për një javë 4-ditëshe 16 ditë pushim. Këto ditë të pushimit punëdhënësi Juaj është i detyruar t'i paguajë. Se sa para do të merrni për një ditë pushim, kjo varet nga rroga mesatare mujore, që Ju merrni.

Vazhdimi i pagesës së rrogës në rast sëmundjeje

Në rast sëmundjeje Juve ju takon për gjashtë javë (maksimalisht) vazhdimi i pagesës së rrogës si dhe në vazhdim paratë për sëmundje. Paratë për sëmundje janë në shumë më të vogla se sa rroga e zakonshme mujore dhe paguhen nga Arka e sigurimit shëndetësor (Krankenkasse).

Masat e mbrojtjes në punë dhe mbrojtja e shëndetit / aksidentet në punë

Puna nuk duhet ta rrezikojë shëndetin dhe sigurinë. Nëse nuk mjaftojnë masat e sigurisë në punë dhe masat e mbrojtjes së shëndetit, punëmarrësit mund të ngulmojnë për përmirësimin e tyre. Nga kjo nuk do të keni asnjë dëm. Aksidentet në punë duhet të paraqiten te Sigurimi ligjor ndaj aksidenteve. Në rast të aksidentit në punë, Ju keni të drejtën për trajtim mjekësor dhe – nëse është e nevojshme - edhe për pension.

Mbrojtja e të rinjve në punë

Punësimi i fëmijëve është i ndaluar me ligj. Si fëmijë llogaritet personi, i cili ende nuk i ka mbushur 15 vjet. Të rinjtë (akoma nën moshën 18 vjeçe) nuk guxojnë të punojnë më shumë se 40 orë në javë.

Mbrojtja e nënave

Gratë shtatzëna, në parim, nuk guxojnë të punojnë gjashtë javët e fundit të shtatzënisë së tyre dhe tetë javë pas lindjes së fëmijës. Gjatë shtatzënisë dhe deri në skadimin e katër javëve pas lindjes largimi nga puna nuk është i lejuar me ligj. Edhe gratë shtatzëna, të cilat nuk qëndrojnë legalisht në Gjermani, kanë të drejtë për përkujdesje mjekësore.

Mbrojtja nga prishja e kontratës së punës

Jo çdo prishje e kontratës është e lejuar me ligj. Gjatë prishjes së kontratës duhet të merren parasysh afatet e caktuara ligjore. Prishja e kontratës duhet të jetë e arsyetuar. Arsytet e prishjes së kontratës mund të qëndrojnë te personi apo te sjellja e tij apo nga hapat e nevojshme të sipërmarrjes (psh. problemet ekonomike të sipërmarrjes).

Vështrim mbi rrogat minimale

Branzhi Gjendja shtator 2011	Rrogat minimale obligative-ligjore për punëmarrësit Varësisht nga kualifikimi, funksioni, regjioni (rroga bruto për orë)	
Ndërtimtari Mjeshtri, vozitësi i vinçit, etj. Ndihmësmjeshtri, punëtori, etj.	Berlin 12,85 € 11,00 €	Brandenburg 9,75 €
Pastrimi i mbeturinave Përfshirë pastrimin e rrugëve, shërbimi gjatë dimrit	Gjermani 8,24 € tani për tani në shqyrtim	
Elektrika	Berlin dhe Brandenburg 8,40 €	
Ndërtimi i pullazeve	Gjermani 10,80 €	
Ngjyrosja dhe lyerja me llak Të kualifikuar, të pakualifikuar	Berlin 11,75 € 9,75 €	Brandenburg 9,75 €
Pastrimi i ndërtesave Brenda etj Pastrimi i qelqit dhe fasadave etj.	Berlin 8,55 € 11,33 €	Brandenburg 7,00 € 8,88 €
Shërbimet e larjes Në objektin e klientëve	Berlin dhe Brandenburg 6,75 €	
Përkujdesja	Berlin 8,50 €	Brandenburg 7,50 €
Puna me afat të caktuar kohor dhe puna me punëtorë të huazur	në të ardhmen pritet kufiri më i ulët i pagës mujore, mirëpo deri më tani ende nuk ka hyrë në fuqi	
Mbikëqyrja dhe sigurimi Psh. bashkëpunëtorët në mbrojtjen e objektit	Berlin dhe Brandenburg 6,53 €* 6,53 €* 6,53 €* 6,53 €*	

*Marrëveshja me vlefshmëri të përgjithshme e shpërblimit tarifor për zanatin e rojtarit dhe sigurimit në Berlin dhe Brandenburg, parasheh pjesërisht pagesa më të larta për çdo orë pune

Informacionet mbi pagat minimale ligjore mund t'i merrni në faqen zyrtare të Ministrisë Federale për Punë dhe Çështje Sociale (BMAS) www.bmas.de/portal/37846/

Shih edhe linkun për regjistrin e përbashkët tarifor në faqen e pasme.